



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr. 54  
Prishtinë, më 4.2.2019, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Driton Çaushti, Abdyl Salihu, Arbërie Nagavci, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Albulena Balaj-Halimaj.

**Munguan:** Valentina Bunjaku-Rexhepi, Fidan Rekaliu, dhe Verica Çeraniq.

**Përfaqësues të tjerë:** përfaqësues të mediave.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Për këtë mbledhje u propozua ky

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 24.1.2019, 25.1.2019 dhe 28.1.2019;
3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për Kinematografinë;
4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta;
5. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-097 për Bibliotekat;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës, njëkohësisht i uroi mirëseardhje anëtares së re të komisionit Luljeta Veselaj-Gutaj.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

### **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 24.1.2019, 25.1.2019 dhe 28.1.2019**

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 26 dhe 28.1.2019, u miratuan pa vërejtje, ndërsa miratimi i procesverbalit të datës 25.1.2019, u shty për mbledhjen e radhës me arsyetimin se materiali është pranuar me vonesë.

### **3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për Kinematografinë**

Ismajl Kurteshi tha se komisioni ka shqyrtuar Projektligjin nr.06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për Kinematografinë dhe ka miratuar raportin me 5 (pesë) amendamente, të cilin e procedoi për komisionet e përhershme, më 7.12.2018, për shqyrtim dhe vlerësim. Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Komisioni për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim dhe Komisioni për Integritet Evropian, kanë shqyrtuar raportin me rekomandime për këtë projektligji dhe kanë konstatuar se amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë dhe nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni, me shumicë votash, vendosi që raportin me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/22 për Kinematografinë, ta procedojë për lexim të dytë.

### **4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta**

Ismajl Kurteshi tha se komisioni ka shqyrtuar Projektligjin nr. 06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe ka miratuar raportin me 3 (tre) amendamente, të cilin më 7.12.2018, e ka proceduar te komisionet e përhershme, për shqyrtim dhe vlerësim. Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Komisioni për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim dhe Komisioni për Integritet Evropian, kanë shqyrtuar raportin me rekomandime për këtë projektligji dhe kanë konstatuar se amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e

zbatueshëm, amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë dhe nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni, me shumicë votash, vendosi që raportin me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, ta procedojë për lexim të dytë.

#### **5. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-097 për Bibliotekat**

Ismajl Kurteshi, lidhur me këtë projektligj, tha se komisioni ka përfunduar me shqyrtimin e Projektligjin nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-097 për Bibliotekat dhe ka miratuar raportin me 2 (dy) amendamente, të cilin e procedoi për në komisionet e përhershme, më 7.12.2018, për shqyrtim dhe vlerësim. Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Komisioni për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim dhe Komisioni për Integritet Evropian, kanë shqyrtuar Raportin me rekomandime për këtë projektligj kanë konstatuar se amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë dhe nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni, me shumicë votash, vendosi që raportin me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-097 për Bibliotekat, ta procedojë për lexim të dytë.

#### **6. Të ndryshme**

Driton Çausi njoftoi anëtarët e komisionit lidhur me takimin e realizuar me laborantët e universiteteve publike, kërkesë kjo në kuadër të ndryshimeve në projektligjin e pagave dhe mbi të gjitha kërkesa e tyre ka të bëjë me statusin e tyre të cilët aktualisht trajtohen si shërbyes civilë dhe natyra e punës së tyre në baza ditore ballafaqohen me rreziqe në punë dhe nuk mendoj se mund të jenë pjesë e administratës, po ashtu edhe kërkesa e tyre për të qenë pjesë e stafit akademik nuk mendoj që është adekuate. Sipas tij gjatë shqyrtimit të projektligjit për Arsimin e Lartë duhet të gjendet një term adekuat që të kenë një kualifikim të duhur.

Ismajl Kurteshi tha se ka takuar këtë grup të laborantëve dhe është i njohur me kërkesat e tyre të cilat kërkesa tha se i ka adresuar te rektori i Universitetit të Prishtinës.

Teuta Haxhiu, në diskutimin e saj, ngriti çështjen e monitorimit të Ligjit për Sponsorizime dhe tha se një ndër arsytet e mos zbatimit të këtij ligji ka të bëjë me mos harmonizimin me Ligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe ligjin për tatimin në të ardhurat personale për sa i përket përqindjes së lejuar, andaj këto dy projektligje janë proceduar për lexim të dytë në seancë plenare dhe sipas informacioneve që ka kjo çështje tani është adresuar përmes amendamenteve. Lidhur me këtë kërkoi mendimin e anëtarëve të komisionit për vazhdimin e monitorimit.

Arbërie Nagavci, ngriti çështjen e përgjigjes së ministrit të Arsimit në raport me punësimin e inspektorëve, në përgjigjen që kemi marrë ka një konfirmim për një marrëveshje në një rast në mes sekretarit të MASHT-it dhe një kryetari të komunës dhe marrëveshja tjetër në mes sekretarit të MASHT-it dhe sekretarit të një ministrie tjetër. Në rastin e parë kemi të bëjmë me transferin e një drejtori të shkollës, kurse në rastin tjetër për një zyrtar të teknologjisë informative, i cili është caktuar inspektor i arsimit me transfer, baza ligjore e këtyre marrëveshjeve bazohet në nenin 28 të Ligjit për Shërbimin Civil, në pikën e parë që i referohet marrëveshja është shumë e përgjithshme ndërkaq rregullores të cilës i referohen është e shfuqizuar. Duke pasur parasysh rëndësinë e inspektoratit të arsimit në përmirësimin e cilësisë, konsideron se transferi i personave jo kompetentë ndikon negativisht në punën e inspektoratit dhe propozon që përsëri t'i drejtohem me një letër ministrit të Arsimit, që të kërkojë ligjshmërinë e këtyre marrëveshjeve dhe ta kemi qëndrimin e ministrit lidhur me këto marrëveshje.

Ismajl Kurteshi, lidhur me çështjet e punësimeve në inspektoratin e arsimit, tha se është shqetësuese mënyra e gjetjes së hapësirave ligjore për realizimin e marrëveshjeve për transfer pa plotësimin e kriterëve bazë, siç është rasti në komunën e Gjilanit, që fare nuk ka përvojë në fushën e arsimit. Në vazhdim njoftoi anëtarët e komisionit lidhur me gatishmërinë e afruar nga WUS-Austria për organizimin një debati publik për projektligjin për Arsimin e Lartë, si dhe gatishmërinë e GIZ për të mbështetur komisionin në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe çështjeve të tjera sipas kërkesës së komisionit.

Anëtarët e komisionit u pajtuan me mbështetjet e afruara nga këto dy organizata.

Sa i përket monitorimit të ligjeve të parapara sipas planit të punës së komisionit tha se për arsyt e cekura më lart hiqet nga agjenda monitorimi i ligjit për Sponsorizime, vazhdohet me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore dhe Ligjit për arsimin parauniversitar dhe nëse ka ndonjë propozim tjetër.

Driton Çausi propozoi që gjatë këtij viti të bëhet mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin e Arsimit.

Ismajl Kurteshi, pasi disa nga anëtarët e komisionit janë ndërruar, propozoi që të formohen grupet punuese për monitorimin e Ligjit për Trashëgiminë Kulturore, Ligjit për arsimin parauniversitar dhe Ligjit për Inspektoratin e Arsimit dhe lidhur me këtë tha se do të jetë pjesëmarrës në të tri grupet punuese, por nuk do ta udhëheq asnjërin.

Mufera Sinik tha se gjatë mandatit të kaluar është bërë mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Arsimin parauniversitar dhe nuk e di sa është e rrugës ta mbikëqyrim prapë.

Arbërie Nagavci tha se gjatë monitorimit të Ligjit për Arsimin para universitar duhet shikuar edhe zbatimin e rekomandimeve nga monitorimi i kaluar, si dhe të bëhen planet për realizim të vizitave në shkollat profesionale dhe institucionet e tjera. Tha se shpreh gatishmërinë për të marrë pjesë në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për Arsimin parauniversitar dhe Ligjit për inspektoratin.

Albulena Balaj-Halimaj tha se lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin parauniversitar propozon Luljeta Veselaj-Gutaj për kryesuese të grupit punues duke parë

përkushtimin e saj në mbikëqyrjen ligjeve në komisionin për të drejtat e njeriut si kusht që ajo të jetë anëtare.

Teuta Haxhiu tha se jam e interesuar për ta udhëhequr grupin punues për Ligjin për Arsimin parauniversitar, por edhe si anëtare qysh do që vendoset në komision.

Abdyl Salihu tha se pajtohet me mbikëqyrjen e tre ligjeve dhe tha se bashkërisht do të japim kontributin tonë sikurse kemi bashkëpunuar edhe më parë.

Luljeta Veselaj-Gutaj tha se bashkërisht do të angazhohemi në përmbushjen detyrave të komisionit, si dhe në procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, i cili do përkushtim dhe angazhim të anëtarëve të grupeve punuese, e në të njëjtën kohë edhe përgjegjësi për pjesëmarrje në takime dhe vizita.

Arbërie Nagavci propozoi që përmes votimit të bëhet përzgjedhja e kryesuesve të grupeve punues.

Pas diskutimeve të anëtarëve të komisionit lidhur me përcaktimin e kryesuesve të grupeve punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, u vendos që kryetari së bashku me dy nënkryetarët të bëjnë propozimet për kryesues dhe anëtarë të grupeve punuese për mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve.

Propozimet janë si vijon:

- Grupi punues për mbikëqyrje të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore, ka këtë përbërje: Arbërie Nagavci, kryesuese dhe Mufera Sinik, Abdyl Salihu e Ismajl Kurteshi anëtarë.
- Grupi punues për mbikëqyrje të Ligjit për arsimin parauniversitar, ka këtë përbërje: Luljeta Veselaj-Gutaj, kryesuese dhe Albulena Balaj-Halimaj, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Ismajl Kurteshi dhe Mufera Sinik anëtarë.
- Grupi punues për mbikëqyrje të Ligjit për Inspektoratin e Arsimit, ka këtë përbërje: Teuta Haxhiu, kryesuese, Driton Çausi, Fidan Rekalu dhe Ismajl Kurteshi anëtarë.

Këto propozime mbetet të votohen në mbledhjen e ardhshme.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15.

***E përgatiti:***

***Stafi mbështetës i komisionit.***

**Kryetari i komisionit,**

-----  
**Ismajl Kurteshi**